



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1691/1 Prot.

Tiranë, më 19.12.2024

**V E N D I M**

**Nr. 314, Datë 19.12.2024**

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 238, datë 14.11.2024, e paraqitur nga z. B.M dhe znj. S.M, të përfaqësuar nga Av. E.M<sup>1</sup> kundër Bashkisë Tiranë me pretendimin për diskriminimin për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “B.M dhe S.M kanë kontaktuar me firmën “P....” shpk, për të realizuar ndërtimin e disa vilave në Prush, Tiranë, duke nënshkruar një Kontratë Bashkëpunimi me nr. 2487 prot, nr. 613/4 kol, datë 01.09.2016.

Në këtë ndërtim është abuzuar, por më korruptive janë relacionet e dorëzuara nga ekspertët inxhinier duke deklaruar se punimet kanë përfunduar sipas kontratës. Kjo është skandaloze kur ndërtimi është vetëm karabina dhe ndërtuar duke shkelur lejen e ndërtimit.

I jemi drejtuar Bashkisë Tiranë ku kemi kërkuar për dorëzimin nga këta specialistë të Akt kontrollit në objekte, por gjejmë të njëjtën përgjigje pakrye. Po ju vë në dispozicion një pjesë dhe të korrespondencës me Bashkinë si dhe relacionet e dorëzuara mbi kontrollin e ushtruar në

<sup>1</sup> Referuar Prokurës së Posaçme nr. rep: 4161, nr. kol: 1465, datë 26.06.2020, të noteres M.D.

*objekte që tregon qartazi për abuzim, me sa duket i kanë bërë nga shtëpia ose zyra pa verifikuar gjendjen aktuale, që është vetëm një karabina.*

*Diskriminimi vjen nga Bashkia Tiranë që nuk ka marrë asnjë masë ndaj këtyre abuzuesve, por vazhdon ti favorizoj akoma, duke u tallur me dinjitetin, personalitetin e familjes M, por dhe me gjakun e kësaj familje që ka derdhur gjithë vlerën për këtë ndërtim. Diskriminimi vazhdon se këta mashtrues nuk janë ndëshkuar akoma nga Bashkia e Tiranës, edhe pse ne ja kemi kërkuar me shkresë zyrtare”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe të mbahet qëndrim ndaj drejtuesve të Bashkisë Tiranë për shpërdorim detyre, pasi nuk kanë ushtruar kontroll sipas ligjit, për të parë si po zbatohet kjo leje ndërtimi.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 19.11.2024 dhe me shkresën nr. 1551/2, datë 03.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjekti ankues që të parashtrorë shpjegime, sa i përket diferencave në trajtim që bazohen në një cilësi apo karakteristikë tjetër të veçantë, që hyn në shkaqet e mbrojtura, që duhet të ketë shërbyer për trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi “*gjendja ekonomike*” si shkak i ndaluar diskriminimi, është një koncept i gjerë, por kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërorë, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze.

Me shkresën datë 09.12.2024, të protokolluar me tonën me nr. 1551/3, datë 11.12.2024, përfaqësuesi i ankuesve, në mes të tjerash informon se: “*B.M dhe S.M, kanë lidhur një kontratë për ndërtimin e tre vilave me firmën e ndërtimit “P....”. Kjo firmë ndërtimi, shkeli me dashje lejen e ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë, duke e detyruar familjen M. ti futet një kalvari gjyqësor, në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Punimet janë ndërprerë për gati tre vjet, pasi u konstatuan shkelje të lejes së ndërtimit. Gjendja sot është vetëm ndërtimi i disa mureve, në shkelje të kontratës së nënshkruar mes palëve.*

*Në gjykatë konstatojmë skandalin që kanë kryer me aktet e kontrollit, akte të rënda, mashtrim dhe falsifikim të dokumentacioneve nga ing. N.M, L.P dhe E.M, inxhinierë të shoqërisë “Studio M.....”, të cilët shkruajnë se ndërtimi ka përfunduar sipas lejes së ndërtimit, kanalizimet janë të rregullta, ngrohja është me panele diellore, etj, ndërkohë kur subjekti “P.....” shpk ka ndërtuar vetëm si karabina, edhe atë ndërtim duke shkelur gjithshka nga leja e ndërtimit.*

*Në këto kushte i kemi kërkuar Bashkisë Tiranë të ngrejë një taks forcë dhe të verifikojë gjendjen reale në terren, si dhe të marrë masat e nevojshme ndaj fallsifikatorëve.*

*Edhe pse kërkesat tona janë të vazhdueshme, përgjigja nga Bashkia Tiranë është si gjithmonë formale, pa ushtruar asnjë kontroll, pa marrë asnjë masë, ndaj këtyre mashtruesve, që*

*shpërdorjnë detyrën, duke nënshkruar dokumente fallso, korruptivë, ku deklarojnë në mënyrë mashtruese, të papërgjegjshëm se punimet kanë përfunduar në përputhje të plotë me dokumentacionin e miratuar për leje ndërtimi.*

*Kërkojmë reagimin e menjëhershëm, të institucionit që mban përgjegjësi mbi zbatimin e legjislacionit në fushën e ndërtimit, Bashkia Tiranë, e cila po e anashkalon pretendimin tonë”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

*Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:*

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tyre i pabarabartë apo i pafavorshëm nga Bashkia Tiranë, ka ardhur për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Subjekti ankues, në rastin në fjalë nuk ka bashkëlidhur asnjë dokumentacion për të dokumentuar gjendjen ekonomike.

*Së pari*, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesit pretendojnë se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij.

*Së dyti*, pasi ankuesit të kenë provuar se mbartin shkakun e pretenduar, duhet që të sjellin indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak, gjendjen ekonomike të tyre, ata janë trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga Bashkia Tiranë.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkakun e gjendjes ekonomike, të pretenduar nga ankuesit si arsyeja ose shkakun për të cilën ata i janë nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm, përsa i takon mosveprimin të Bashkisë Tiranë, për të kontrolluar zbatimin e lejes së ndërtimit të firmës “P.....” shpk.

LMD nuk jep një përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes ekonomike. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, diferencat në trajtim që bazohen në gjendjen ekonomike të një personi<sup>2</sup> ose grupi personash ose e thënë ndryshe në mbështetjen financiare që individi apo familja përfiton nga skemat e përkrahjes sociale, do të konsiderohen si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen ekonomike. Komisioneri vlerëson se, *gjendja ekonomike si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që i bëhet një personi apo grup personash dhe ky trajtim lidhet me gjendjen e tyre ekonomike, siç janë familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Në dokumentacionin e dorëzuar, rezulton se ankuesit janë pronarë, kanë të regjistruar në ZVRPP Tiranë pasuri të paluajtshme dhe kanë lidhur kontratë me një kompani ndërtimi, për ndërtimin e një kompleksi të përbërë nga tre vila trekatëshe. Në këtë kuptim, gjendja ekonomike e ankuesve, nuk është shkak që hyn në shkaqet e mbrojtura.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se shkakun e gjendjes ekonomike i pretenduar nga ankuesit, është një shkak i mbrojtur nga diskriminimi, pretendimet e paraqitura nga ankuesit, nuk mund të përfshihen në kuadër të shkakut të gjendjes ekonomike.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjektet ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes lidhur me këtë shkak.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: ....., ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet

---

<sup>2</sup> Shiko: Vendimet nr. 33, datë 04.04.2020 dhe nr. 171, datë 31.05.2024, të KMD-së.

dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>3</sup>.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 238, datë 14.11.2024, të subjekteve ankues B.M dhe S.M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

---

<sup>3</sup> Për analogji citojmë vendimet: nr. 261, datë 28.12.2023; nr. 36, datë 05.02.2024 dhe nr. 241, datë 09.09.2024, të KMD-së.